

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN MIRAS DEVOLL

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Miras, Devoll**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 71, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 370/8, datë 30.06.2014, i ka rekomanduar z. Kryetar Sejdo, Kryetar i Komunës Miras, Devoll, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Komuna Miras të marrë të gjitha hapat ligjorë, për regjistrimin në ZVRPP Devoll, të 180 pronave pyje dhe kullota të kaluar në pronësi të Komunës Miras me VKM. nr. 622, datë 14.05.2008 “*Për Miratimin përfundimtarë të Pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, Komunës.*

Menjëherë

2. Komuna të marrë masa dhe të saktësoj sipërfaqen e tokës bujqësore te pandarë për 1,065 ha tokë sipas parcelave dhe të inventarizohet.

Menjëherë

3. Komunës të marrë masa për plotësimin e regjistrit pronave sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik*”, kreu III-të “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26.

Menjëherë

4. Financa e komunës të kryej procedurat, duke anuluar nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarëve të vjedhur në muzeumin “*Dritro Agolli*” në vlerën 987,960 lekë.

Menjëherë

5. Zyra e Urbanistikes të marre masa për llogartitjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas vleres preventivit, në rast se vlera e preventivit është më e vogël se vlera sipas çmimeve të EKB, llogaritja të realizohet sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave. Të mos miratohen leje Përdorimi në rast se subjekti sipërmarrës nuk ka shlyer detyrimet Tatimore.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë*”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin të vlerës **2,520,966 lekë dëm ekonomik**, si më poshtë:

1. **vlera 2,350,466 leke**, për mospagesën e taksës ndikimit infrastrukturës për lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit, për vitin 2012- 2013 dhe para periudhës së auditimit, për 11 subjekte,

përkatësisht: M.Z. 105,013 leke, E.Z. 105,013 leke, D.M. 127,280 leke, D.M. 290,082 leke, R.M., 186,286 leke, Xh.I. 48,439 leke, D.D. 137,833 leke, I.M. dhe A.S. 1,132,114 leke, N. B. 65,474 leke, H. M. 66,368 leke, N.Z. 86,564 leke, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar sipas ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e territorit”, me ligjin 8402, datë 10.9.1998, “Për Kontrollin e disiplinimit e punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9200, datë 26.02.2004.

2. vlera 70,000 leke, për përfitim tepër shpenzime celulare për vitin 2012 dhe 2013, në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pwr K.A.

3. vlera 100,500 leke, për mos pagese dhe mos kontabilizim të taksave vendore nga 3 biznese, përkatësisht V.K. 32,500 lekë, A.B. 33,500 lekë dhe A.L. 34,500 lekë.

Brenda datës 30.9.2014

C. MASA DISIPLINORE

III. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 144 dhe 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, **kërkojmë** që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000

“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, kryetari i Komunës Miras të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

“Vrejtje me paralajmërim,” për:

1. B.A., me detyrë **Drejtor Urbanistikes** Planifikimit dhe Territorit dhe në cilësinë e kryetarit të Njesisë Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos aplikimin e sakte dhe mos arkëtimin e taksës ndikimit infrastrukturës për 11 subjekte, çka ka shkaktuar vlerën 2,3 milion lekë dem ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e nenit 51 të ligjit të Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998 i ndryshuar sipas ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e territorit” si dhe me ligjin 8402, datë 10.9.1998, “Për Kontrollin e disiplinimit e punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9200, datë 26.02.2004.

-Për mos inventarizimin e dosjeve të urbanistikes, për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe shfrytëzimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

-Për hartimin e dokumentacionit të prokurimeve me ndryshime, për kushtet kualifikuese në 1 rast, përkatësisht *për disponimin e dokumentit pronësisë ose të kontratës noteriale të qerese* për 3 betonieret dhe skelarin, në tenderin e rrugës *Zicisht Fitore* dhe *Rikonstruksion zyra Komunës Miras*, ku për njërin rast është vendosur ndërsa për rastin tjetër nuk është vendosur. Për mos vendosjen e kriterit të disponimit të licencës së drejtuesit teknik, ndryshe nga tenderi i rrugës *Fitore-Ziqisht* ku ky kusht është vendosur.

-Për mangësi në disa raste në procedurat e prokurimit me vlera të vogla për shërbime, në kundërshtim Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 “Për procedurën prokurimit vlera vogla” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36.

2. D.S. me detyrë N/kryetare i Komunës dhe Drejtor i shërbimeve si dhe në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatoreve ekonomik në 2 raste, në kushtet me mangësi në dokumentacion, por pa efekte financiare, përkatesisht:

a. për tenderin e zhvilluar me objekt: *Asfaltimi i rrugës Fitore-Ziçisht, ne vitin 2012*, për operatorin ekonomik fitues *shpk Niem*, pasi mungon dokumenti i pronësisë së 3 betonierëve *pajisje te vogla stacionare dhe mungon licenca e drejtuesit teknik, ne kundërshtim me piken 4/7,Ç dhe pika 2 dhe 3 °aftësitë tekniko'profesionale°* te kriterëve te veçanta te kualifikimit, si dhe me *piken 1 germa d °aftësite tekniko'profesionale°*,

b. për tenderin e *rikonstruksionit zyrove komunës*, për operatorin ekonomik fitues *shpk A..., II*, pasi mungon dokumenti i pronësisë për 3 betoniere dhe skelari, ne kundërshtim me kriteret e veçanta te kualifikimit *pika 3 °Mjetet dhe pajisjet teknike°*, te VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, germa “a”.

-Për mangësi ne disa raste ne procedurat e prokurimit me vlera të vogla për shërbime, në kundërshtim Udhëzimin e APP nr. 28, datë 18.02.2008 *“Për procedurën prokurimit vlera vogla”* dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36.

3. I.K. me detyrë përgjegjëse e taksave vendore, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizim te ardhurave nga taksat e tarifat vendore dhe mangësi ne funksionimin e saj, pasi për vitin 2012 rezultojnë 2,646 mijë leke mungese te ardhurash dhe për vitin 2013 për 3,356 mijë lekë mungese te ardhurash, ne kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 *“Për Sistemin e Taksave Lokale”* me ndryshime.

-Për mangësi ne planifikimin dhe realizimin e taksës mbi ndërtesën, pasi kjo takse për popullatën është përllogaritur nen mungesën e të dhënave për sipërfaqet e ndërtimit, ndërsa për biznesin është llogaritur nen mungesën e të dhënave nga ZVRPP.

-Për mangësi ne planifikimin dhe realizimin e taksës tokës bujqësore, pasi disa familje nuk shlyejnë këtë takse.

-Për mos vjeljen e 3 debitorëve te taksave vendore për vlerën 100,500 lekë dëm ekonomik.

-Për mos aplikim gjoba brenda afatit të caktuar, sipas nenit 17,” Kundravajtjet dhe sanksionet “,pika 1a, Për mungese kontrole të dokumentuara sipas nenit nr. 15,” Mbajtja e regjistrimeve”, ku në pikën nr. 1.

“Vrejtje me shkrim,”, për:

4. M.H. me detyrë Drejtoreshe e financës dhe në cilësinë e anëtares se njësisë prokurimit si dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejin e kryerjes se shpenzimeve celulare te tepërta ne për vitin 2012 dhe 2013, çka ka krijuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë për vlerën 70 mije leke, në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 *“Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”*, pika 9,

-Për shkelje ne kryerjen e inventarit fizik brenda vitit kalendarik 2013, çka bie ndesh me UMF nr. 30, datë 27.11.2011,” *Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik kapitulli, IV” Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve*”,inventarizimi i aktive e pika nr. 74. Njëkohësisht dhe për mos kryerjen e inventarit fizik te magazinës siç përcaktohet në pikën nr. 81, të UMF

-Për hartimin e dokumentacionit te prokurimeve me ndryshime për kushtet kualifikuese ne 1 rast, përkatësisht *për disponimin e dokumentit pronësisë ose te kontratës noteriale te qerase* për 3 betoniere dhe skelarinë, ne tenderin e *rrugës Zicisht Fitore dhe Rikonstruksion zyra Komunës Miras*, ku për njërin rast është vendosur ndërsa per rastin tjetër nuk është vendosur. Nuk ka vendosur kriterin e disponimit te licencës se drejtuesit teknik, ndryshe nga tenderi i *rrugës Fitore-Ziqisht* ku ky kusht është vendosur.

5. A.S. me detyrë sekretare dhe në cilësinë e anëtares te KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues te operatoreve ekonomik ne 2 raste, ne kushtet me mangesi ne dokumentacion, pa efekte financiare, përketesisht:

a. për tenderin e zhvilluar me objekt: *Asfaltimi i rrugës Fitore-Ziçisht, ne vitin 2012*, për operatorin ekonomik fitues *shpk Niem*, pasi mungon dokumenti qe provon pronësinë e 3 betonierëve *pajisje te vogla stacionare* dhe mungon licenca e drejtuesit teknik, ne kundërshtim me *piken 4/7,Ç dhe pika 2 dhe 3 °aftesite tekniko'profesionale°* te kriterave te veçanta te kualifikimit, si dhe me *piken 1 germa d °aftesite tekniko'profesionale*,

b. për tenderin e *rikonstruksionit zyrrave komunës*, për operatorin ekonomik fitues *shpk A... II*, pasi mungon dokumenti i pronësisë për 3 betoniere dhe skelari, ne kundërshtim me kriteret e veçanta te kualifikimit *pika 3 °Mjetet dhe pajisjet teknike°*, te VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "*Për rregullat e prokurimit publik*", i ndryshuar, Kreu VII, "Kushte të përgjithshme për zbatim", pika 1, germa "a".

6. Sh.H. me detyrë llogaritare dhe në cilësinë e anëtares te KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues te operatoreve ekonomik ne 2 raste, ne kushtet me mangesi ne dokumentacion, pa efekte financiare, përketesisht:

a. për tenderin e zhvilluar me objekt: *Asfaltimi i rrugës Fitore-Ziçisht, ne vitin 2012*, për operatorin ekonomik fitues *N... shpk*, pasi mungon dokumenti qe provon pronësinë e 3 betonierëve *pajisje te vogla stacionare* dhe mungon licenca e drejtuesit teknik, ne kundërshtim me *piken 4/7,Ç dhe pika 2 dhe 3 °aftesite tekniko'profesionale°* te kriterave te veçanta te kualifikimit, si dhe me *piken 1 germa d °aftesite tekniko'profesionale°*,

b. për tenderin e *rikonstruksionit zyrrave komunës*, për operatorin ekonomik fitues *shpk A... II*, pasi mungon dokumenti i pronësisë për 3 betoniere dhe skelari, ne kundërshtim me kriteret e veçanta te kualifikimit *pika 3 °Mjetet dhe pajisjet teknike°*, te VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "*Për rregullat e prokurimit publik*", i ndryshuar, Kreu VII, "Kushte të përgjithshme për zbatim", pika 1, germa "a".

-Për mangësi ne disa raste ne procedurat e prokurimit me vlera të vogla për shërbime, në kundërshtim Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 "*Për procedurën prokurimit vlera vogla*" dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36.

7. Babis Hoxha, me detyrë polic komunës dhe

8. Urim Backa, me detyrë polic komunës, për shkeljet e mëposhtme:

-Për pune te dobët ne funksionimin dhe kryerjen e detyrave te përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, në ligjin nr. 8224, datë 15.7.1997 "*Për organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe të komunës*", i ndryshuar me Ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, si dhe aktet nënligjore të nxjerra për në zbatim të tij.

-Për mos disponim te librit shërbimit, dhe praktikës dokumentare te korrespondencës me sektorët e tjerë të Komunës, në zbatim te kreut VII-të të Rregullores së Brendshme "TIP" të Policisë së Bashkisë dhe Komunës,

-Për mungese te planeve te punës, dhe në mos koordinimin me zyrrat tjera, të cilat veprojnë brenda strukturave të komunës,

-Për mos plotësimin e praktikës se plotë në zgjidhjen e ankesave të qytetarëve dhe informimit me shkrim për zbatimin e urdhrave të Kryetarit të Komunës.

Nga Komuna Miras, Devoll me shkresë nr.311/1 prot, datë 15.07.2014, protokolluar në KLSH me nr.370/9 datë 17.07.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Besim Bileri, Pal Dajçi dhe Besmir Paja, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT